



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Prilimi/Prodato Received/Delivery	15.08.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/H.M.	4749/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr. 742/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar - Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti anëtarë, me Rushit Kajtazi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 742/2021 të datës 20.08.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga nga Komuna e Prishtinës, e parashtruar për mes Shoqërisë së Avokateve sipas Aktgjykimit të datës 29.06.2022, A. Nr. 2660/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative kundër organit të punësimit Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në çështjen juridike "Mase disiplinor", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.08..2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër me ankesën A. Nr. 742/2021 të datës 20.08.2021, të parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi i datës 21.07.2021, me numër protokollit 0261, i Komisionit Disiplinor i Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 20.08.2021 me numër protokollit 4287/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore kundër Vendimi të datës 21.07.2021, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.10.2021, me numër protokoll 4897/2021, ka njoftuar ankuesin _____ se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 742/2021, të datës 20.08.2021, për shkak se Këshilli nuk funksionon, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi _____ i pakënaqur me njoftimin e datës 20.08.2021, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.06.2022, A. Nr. 2660/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 04.10.2021, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr.742/2021, të datës 20.08.2021 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova; Ankesën A. Nr. 742/2021e datës 20.08.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr. 2660/2021, i datës 29.06.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative; Vendimi i datës 21.07.2021, i Komisionit Disiplinor; Autorizimi i datës 12.08.2021; e- maili i datës 17.11.2021; Akt emërimi i datës 04.04.2017; e- maili i datës 23.06.2021; e- maili i datës 28.06.2021; e- maili i datës 29.06.2021; e- maili i datës 07.06.2021; Intervista e datës 05.07.2021; Intervista e datës 14.07.2021; e- maili i datës 15.07.2021; e- maili i datës 16.07.2021; e- maili i datës 22.07.2021; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 22.06.2021; njoftimi i datës 21.05.2021; Njoftimi i datës 04.10.2021, i Këshillit; Vendimi i datës 10.07.2020; Përgjigje në ankesë e datës 06.09.2021, me numër protokoll 4502/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e *pabazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror, me datën 21.07.2021, me numër protokoll 0261 ka nxjerr vendim me të cilin i ka shqiptuar masën disiplinore „ *Largim nga shërbimi Civil*“. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se perëndimet ankimore të ankuesit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankuesit si në vijmë, ankuesi nga data 01.05.2021 është ka qenë i obliguar të paraqitet në vendin e tije të punës pas përfundimit të pushimit pa pagesë, ankuesi nga Menaxheri i Personelit është njoftuar me datë 15.02.2021 përmes imellit zyrtar se me datë 01.05.2021 është dita kur ankuesi duhet të paraqitet në punë. Ankuesi pretendon se nuk ka pasur qasje në imell zyrtar për të pranuar njoftimin e Menaxherit të Burimeve Njerëzore, Kolegji konstaton se ky pretendim

nuk është i qëndrueshëm, sepse ankuesi ka qenë i vetëdijshëm se në cilën datë duhet të paraqitet në punë, në anën tjetër ankuesi me datë 05.05.2021 përmes imellës zyrtare ka bërë kërkesë në ASHN për zgjatjen e kohës së pushimit pa pagesë, ky veprim dëshmon pa asnjë dyshim se ankuesi ka pasur qasje në imell zyrtar dhe ka qenë në dijeni se të njëjti i përfundon pushimi pa pagesë me datë 01.05.2021.

Kolegji, konstaton se pavarësisht që ankuesi ka bërë ankesë në ASHN për zgjatjen e pushimit pa pagesë i njëjti nuk ka pasur të drejtë që pa aprovim të qëndroj në pushim pa pagesë, prandaj Kolegji merr si të mirëqenë konstatimin e Komisionit Disiplinor të ASHN se ankuesi nuk është paraqit në vendin e tij të punës për 33 ditë, prandaj Kolegji konstaton se kjo është një rrethanë faktike dhe ligjore që ndaj ankuesit të shqiptohet masa "largim nga shërbimi civil" dhe masa është në proporcion të plotë me veprimet e ankuesit.

Prandaj Kolegji konstaton se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore për ankuesin "Largim nga shërbimi Civil", Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 47, paragrafi 1, nen paragrafi 1.4, të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, ku thuhet se; **Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, si dhe në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1,dhe 1.2 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku thuhet se; 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore"**.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se nëpunësi civil me veprimet e tije, lidhur në rastin e mungesës në punë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 46, paragrafi 1, nen paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, ku thuhet se; 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; si dhe në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullore (QRK) nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se; 1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik. 2. Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore, Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave konstaton se Menaxheri i Departamentit për Burime Njerëzore me datë 15.02.2021, ankuesin për mes e- mailit e ka njoftuar se bazuar në situatën e krijuar nga pandemia Covit 19, si dhe duke u bazuar ne vendimet për pushim pa pagese, Drejtori z, afati i fundit për paraqitje në punë është 01.05.2021, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave si prove relevantë ka analizuar vijueshmërinë në punë, për ankuesin ku konstatohet se ankuesi nuk është regjistruar në regjistrin e vijueshmërisë, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se në rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 21.07.2021, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror, me të cilin vendim ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", ka vepruar në pajtim me dispozitat Ligji nr. 06/1 -114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren

(QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me rastin e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 742/2021*

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Estref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Shoqërisë së Avokateve

Gjyqtarit

Administrative

Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;

Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror;

Arkivit të KPMSHCK-së

në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje